



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4178/2 Prot.

Patos, më 19.11.2024

**Lënda:** Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Patos.

**Drejtuar:** Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Patos.

**Për dijeni:** Prefektit të Qarkut Fier.

Kryetarit të Bashkisë Patos.

Në zbatim të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2 germa (a) të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ju njoftojmë se ditën e mërkurë, datë 27.11.2024, ora 14<sup>00</sup>, në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Patos do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Patos, me këtë rend dite

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.10.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.10.2024.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Tetor 2024”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Tetor 2024”.
- 6- Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “fondi kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” në vlerën 88,000 mijë (tetëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe “fondi i pa kushtëzuar për mbrojtjen civile” në vlerën 47,000 mijë (dyzetë e shtatë mijë) lekë për z. Fatmir Bilaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “Naftëtari”.
- 7- Projekt-vendim “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”.
- 8- Projekt-vendim “Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, Institucioneve në Vartësi dhe të Njësisve Administrative për vitin 2025”.
- 9- Projekt-vendim “Për miratimin e planit të aktiviteteve për vitin 2025, Planin e konsultimeve dhe buxhetit të këshillit bashkiak Patos për vitin 2025”.

**MBLEDHJET E KOMISIONEVE**

**Komisioni i Ekonomisë, Financës dhe Ndhimave Ekonomike**, do të shqyrtojë pikat 4 , 5, 6, 7  
8 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, **ditën e hënë datë 25.11.2024, ora 10:00.**

KRYETARI  
Armand Ahmetaj

